



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 115

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 5 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 56/2024, datë 6.6.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar..... 13823
Dekret i Presidentit nr. 242, datë 28.6.2024	Për shpallje ligji..... 13827
Ligj nr. 62/2024, datë 12.6.2024	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për ndryshimin e nenit 50(A) të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, si dhe në protokollin për ndryshimin e nenit 56 të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar..... 13827
Dekret i Presidentit nr. 243, datë 28.6.2024	Për shpallje ligji..... 13840
Vendim i Kuvendit nr. 59/2024, datë 27.6.2024	Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45/2016, “Për vullnetarizmin”..... 13840
Vendim i Kuvendit nr. 60/2024, datë 27.6.2024	Për rrëzimin e listës së parë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar..... 13840
Vendim i Kuvendit nr. 61/2024, datë 27.6.2024	Për rrëzimin e listës së parë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar..... 13841
Rezolutë e Kuvendit datë 27.6.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2023..... 13841
Rezolutë e Kuvendit datë 27.6.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2023..... 13842
Rezolutë e Kuvendit datë 27.6.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe postare për vitin 2023..... 13843

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 473, datë 24.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....	13845
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 474, datë 24.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	13846
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 475, datë 24.6.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 780, datë 29.12.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Holandës”	13846
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 476, datë 24.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Gjermanisë	13847
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 477, datë 24.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	13849
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 478, datë 24.6.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	13852
Vendim i Këshillit të Lartë të Arkivave nr. 2, datë 3.4.2024	Për shprehjen e dakordësisë mbi caktimin e tarifave të shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.....	13854
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 110, datë 10.6.2024	Për një ndryshim në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022.....	13856
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 10149, datë 3.7.2024	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	13859
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 310/10, datë 1.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 428, datë 19.7.2023, për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruktion i rrugës ekzistues Vlorë–Orikum dhe dy <i>bypass</i> -eve në Radhimë, Vlorë”	13859



LIGJ
Nr. 56/2024

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 10129, DATË 11.5.2009,
“PËR GJENDJEN CIVILE”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është kuptimi dhe përbërësit e gjendjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, përcaktimi i rregullave për hedhjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre, si dhe organizimi e funksionimi i shërbimit të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 2

Në nenin 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 1, 2 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“1. “Gjendja civile” është tërësia e të dhënave personale të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, të cilat regjistrohen dhe mbahen në Regjistrin Kombëtar

dhe që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin, lidhjet ose marrëdhëniet ndërmjet tyre.

2. “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile” në vijim “Regjistri Kombëtar”, është baza e të dhënave shtetërore, ku pasqyrohen dhe përditësohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi shqiptar, shtetasi të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë.

4. “Përbërës të gjendjes civile” janë të gjitha elementet e përcaktuara në këtë ligj, që shërbejnë për përcaktimin e identitetit të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi, me vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë.”.

2. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. “Vendbanimi” dhe “Vendqëndrimi”, si përbërës të gjendjes civile, kanë të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në Kodin Civil.”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4
Vlera juridike e të dhënave

1. Të dhënat e gjendjes civile janë të vlefshme kur lëshohen nga nëpunës të shërbimit të gjendjes civile ose kur lëshohen me mjete elektronike, në mënyrën dhe formën e parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij.

2. Për çdo dokument fizik që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuar me ligj, nëpunësi i zyrës së gjendjes civile shënon në mënyrë të plotë emrin, mbiemrin, nënshkrimin e vet dhe përdor vulën zyrtare të shërbimit të gjendjes civile.

3. Çdo dokument elektronik, që u jepet shtetasve, institucioneve dhe organeve të autorizuar me ligj, përmban nënshkrimin elektronik të nëpunësit që e lëshon. Dokumentet elektronike që postohen nga Regjistri Kombëtar, në sesionin “Dokumentet e mia”, në portalin unik qeveritar “e-Albania”, përmbajnë vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.”.



Neni 4

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14

Deklarimi dhe ndryshimi i vendbanimit ose vendqëndrimit

1. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e vendbanimit dhe vendqëndrimit brenda vendit, si dhe ndryshimin e tyre, sipas të gjitha elementeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për sistemin e adresave.

2. Institucionet shëndetësore dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale bëjnë deklarinë e vendqëndrimit të shtetasve, qëndrimi i të cilëve në këto institucione zgjat më shumë se 3 (tre) muaj, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga data e përmbushjes së afatit.

3. Regjistrimi i vendbanimit dhe vendqëndrimit kryhet nga zyra e gjendjes civile në njësinë administrative, që ka në juridiksion territorial vendbanimin ose vendqëndrimin, pas marrjes së kërkesës nga shtetasi. Shtetasi nuk mund të deklarojë më shumë se një vendbanim ose një vendqëndrim njëherazi.

4. Ndryshimi i vendbanimit ose vendqëndrimit kryhet nga zyra e gjendjes civile të njësisë administrative që ka në juridiksion territorial vendbanimin ose vendqëndrimin e ri, pas marrjes së kërkesës nga shtetasi. Shtetasi duhet të deklarojë vendbanimin ose vendqëndrimin e ri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga zhvendosja në këtë vendbanim ose vendqëndrim.

5. Një ose më shumë familje kanë të drejtë të banojnë në vendbanimin e një familjeje tjetër vetëm kur plotësohen standardet për sipërfaqen minimale të banimit që duhet të ketë një individ në banesë, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

6. Nëpunësi i gjendjes civile, në mbështetje të dokumentacionit zyrtar të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse ku përcaktohet sipërfaqja e banesës, kryen verifikimin nëse përmbushet standardi i sipërfaqes minimale të banimit, sipas pikës 5 të këtij neni.

7. Mënyra e paraqitjes së kërkesës, dokumentacionit të nevojshëm, rregullat për deklarinë dhe ndryshimin e vendbanimit ose vendqëndrimit të shtetasve dhe institucioneve

shtetërore, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Shtetasit, që kërkojnë të kryejnë veprime në regjistrin e gjendjes civile, duhet të kenë përmbushur detyrimin për deklarinë e ndryshimit të vendbanimit ose vendqëndrimit.”.

Neni 5

Nenet 15 dhe 17 shfuqizohen.

Neni 6

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Vendbanimi në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe të kurimit mjekësor afatgjatë për qëllime zgjedhore

1. Për shtetasit që kryejnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit apo janë vendosur në institucionet e paraburgimit ose shtetasit që qëndrojnë pa ndërprerje në institucione shëndetësore për kurim afatgjatë dhe që përfshin qëndrimin e tyre në to edhe datën e zgjedhjeve, vendbanim për qëllime të zbatimit të legjislacionit për zgjedhjet konsiderohet adresa e institucionit përkatës.

2. Institucionet përkatëse jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve njoftojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që qëndrojnë në këto institucione në përputhje me pikën 1 të këtij neni. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nëpërmjet zyrave përkatëse të gjendjes civile dhe sipas përcaktimeve të ligjit për zgjedhjet harton dhe printon listat e zgjedhësve për këta shtetas që deri në datën e zgjedhjeve ndodhen në këto institucione. Këtyre shtetasve iu mundësohet votimi në qendrën e votimit të krijuar, sipas ligjit zgjedhor në këto institucione. Lista e zgjedhësve e hartuar sipas këtij neni është e vlefshme vetëm për zgjedhjet e radhës dhe ripërsëritet sipas të njëjtave modalitete për çdo zgjedhje.

3. Ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri i Drejtësisë përcaktojnë me udhëzim të përbashkët rregullat e njoftimit dhe bashkëpunimit të institucioneve për këta shtetas, procedurën e çregjistrimit dhe regjistrimit të gjendjes civile të



vendbanimit për qëllime zgjedhore sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen.”.

Neni 7

Nenet 19 dhe 20 shfuqizohen.

Neni 8

Neni 21 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 21

Regjistrimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj me leje qëndrimi, shtetasve të huaj që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, si dhe të personave pa shtetësi

1.Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj me leje qëndrimi dhe të personave pa shtetësi, me vendqëndrim në Republikën e Shqipërisë, kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për të huajt.

2.Regjistrimi dhe ndryshimi i vendqëndrimit të shtetasve të huaj, që kanë fituar statusin e refugjatit ose mbrojtjes plotësuese, kryhet sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për azilin.”.

Neni 9

Neni 22 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 25 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në paragrafin e dytë të pikës 1 togfjalëshi “sipas ligjit” zëvendësohet me fjalët “në formë fizike ose elektronike, sipas ligjit në fuqi”.

2. Në pikën 2 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fjalinë e parë të pikës 2 pas fjalës “mban” shtohen fjalët “harton dhe administron”.

b) Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë: “dh) vendimet e komisionit kombëtar për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit.”.

c) Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) vendimet për korrigjimin e gabimit material të drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile.”.

3. Shkronja “a” e pikës 3 shfuqizohet.

Neni 11

Në pikën 1 të nenit 32 fjalët “përgjegjësi i gjendjes civile të Bashkisë së Tiranës” hiqen.

Neni 12

Pikat 1 dhe 4 të nenit 33 shfuqizohen.

Neni 13

Neni 35 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 35

Regjistrimi në Regjistrin Kombëtar

1. Në Regjistrin Kombëtar, në seksionin e të dhënave personale, pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi të përcaktuar në pikën 2 të nenit 2 të këtij ligji.

2. Rregullat e regjistrimit, të dhënat parësore, të dhënat dytësore, dhënësit e informacionit, ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave dhe niveli i aksesimit për bazën e të dhënave të Regjistrit Kombëtar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 14

Pika 6 e nenit 47 ndryshohet si më poshtë:

“6. Rregullat dhe procedura për lidhjen e martesës dhe dokumentacioni që duhet të mbahet nga gjendja civile për lidhjen e martesës, si dhe për ndryshimin e mbiemrit, kur ndodh për shkak të martesës, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”.

Neni 15

Pas pikës 2 të nenit 51 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Rregullat dhe procedurat për regjistrimin e fëmijëve, që lindin të vdekur, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për gjendjen civile.”.

Neni 16

Në nenin 61 bëhen këto ndryshime:



1. Në pikën 2 togfjalëshi “edhe nga” zëvendësohet me togfjalëshin “edhe në”.

2. Pikat 3 dhe 4 shfuqizohen.

Neni 17

Pas shkronjës “e” të nenit 67 shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) lëshojnë vërtetim ku konfirmohet fakti që është i njëjti person, kur, për shtetasit shqiptarë, nga një transkriptim në tjetrin ka gabime në një ose më shumë përbërës të gjendjes civile.”.

Neni 18

Neni 70 shfuqizohet.

Neni 19

Neni 71 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 71

Detyrat e shërbimit të gjendjes civile në misione diplomatike dhe poste konsullore

1. Nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore kryejnë të njëjtat veprime si nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe trajnohen përpara fillimit të detyrës si nëpunësit e gjendjes civile.

2. Nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore, përgjegjës për shërbimin e gjendjes civile, administrojnë dokumentacionin dhe kryejnë veprime në Regjistrin Kombëtar për shtetasit shqiptarë me vendqëndrim jashtë Shqipërisë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj dhe në dispozitat e tjera ligjore.

3. Veprimet, rregullat e administrimit dhe përcjelljes së dokumenteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit shqiptarë, të cilat kryhen nga nëpunësit në misione diplomatike dhe poste konsullore miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për gjendjen civile dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.”.

Neni 20

Pikat 1 dhe 2 të nenit 74 ndryshohen si më poshtë:

“1. Në kuptim të këtij ligji, shkeljet e përmendura më poshtë, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 52, pikat 5 dhe 7, dënohet me gjobë në masën nga 3 000 lekë deri në 5 000 lekë.

b) shkelja ose mosrespektimi i dispozitave të parashikuara në nenin 3, pika 1, nenin 41/1, pika 1, në nenin 52, pika 4, nenin 65, shkronja “g”, nenin 66 dhe në nenin 68, pikat 2 dhe 3, dënohet me gjobë në masën nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë.

2. Gjambat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni vendosen nga drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile. Kundër vendosjes së masës administrative me gjobë bëhet ankim brenda 30 (tridhjetë) ditëve pranë ministrit përgjegjës për gjendjen civile, i cili brenda 10 (dhjetë) ditëve duhet të shprehet për këtë masë. Kundër urdhrat të ministrit përgjegjës për gjendjen civile bëhet ankim në gjykatë, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.”.

Neni 21

1. Kudo në ligj fjalët “përfaqësitë diplomatike dhe konsullore”, “përfaqësive diplomatike jashtë shtetit”, “përfaqësive diplomatike ose konsullore”, “përfaqësive diplomatike” zëvendësohen përkatësisht me fjalët “misionet diplomatike dhe postet konsullore”, “misionet diplomatike dhe posteve konsullore”, “misionet diplomatike ose posteve konsullore”, “misionet diplomatike dhe posteve konsullore”.

2. Kudo në ligj fjalët “që mbulon” zëvendësohen me fjalët “përgjegjës për”.

Neni 22

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore të parashikuara në nenet 4 dhe 13 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile që brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij



ligji të miratojë aktet nënligjore të përcaktuara në nenet 14 dhe 15 të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri i Drejtësisë të miratojnë udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 6 të këtij ligji.

4. Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile dhe ministri përgjegjës për punët e jashtme të miratojnë udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 19 të këtij ligji.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.6.2024.

Shpallur me dekreten nr. 242, datë 28.6.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 242, datë 28.6.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 56/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, ‘Për gjendjen civile’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 62/2024

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN
PËR NDRYSHIMIN E NENIT 50(A) TË
KONVENTËS SË AVIACIONIT CIVIL
NDËRKOMBËTAR, SI DHE NË
PROTOKOLLIN PËR NDRYSHIMIN E
NENIT 56 TË KONVENTËS SË
AVIACIONIT CIVIL NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin për ndryshimin e nenit 50(A) të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, si dhe në protokollin për ndryshimin e nenit 56 të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 12.6.2024.

Shpallur me dekreten nr. 243, datë 28.6.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

PROTOKOLL
**NË LIDHJE ME NJË NDRYSHIM TË
NENIT 50(a) TË KONVENTËS SË
AVIACIONIT CIVIL NDËRKOMBËTAR**
Nënshtuar në Montreal, më 6 tetor 2016

Kuvendi i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil,
duke u takuar në Sesionin e tij të Tridhjetë e Nëntë në Montreal, më 1 tetor 2016,



duke pasur parasysh se është dëshira e një numri të madh Shtetesh Kontraktuese që të zgjerojnë anëtarësimin e Këshillit, në mënyrë që të sigurohet një ekuilibër më i mirë nëpërmjet një përfaqësimi më të madh të Shteteve Kontraktuese;

duke e konsideruar të përshtatshme rritjen e anëtarësisë së këtij organi nga tridhjetë e gjashtë në dyzet;

duke e konsideruar nevojën për të ndryshuar, për qëllimin e lartpërmendur, Konventën e Aviacionit Civil Ndërkombëtar, bërë në Çikago në ditën e shtatë të dhjetorit 1944:

1. Miraton, në përputhje me dispozitat e nenit 94 (a) të Konventes së lartpërmendur, ndryshimin e propozuar në vijim të Konventës në fjalë:

“Në nenin 50 (a) të Konventës fjalja e dytë ndryshohet, duke zëvendësuar “tridhjetë e gjashtë” me “dyzet”.

2. Përcakton, në përputhje me dispozitat e nenit 94 (a) në fjalë të kësaj Konvente, njëqind e njëzet e tetë, si numrin e Shteteve Kontraktuese mbi ratifikimin e të cilave ndryshimi i propozuar do të hyjë në fuqi.

3. Vendos që Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil të hartojë një Protokoll në gjuhët angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, secila prej të cilave do të jetë njëloj autentike, duke përfshirë ndryshimin e lartpërmendur dhe çështjet që paraqiten më poshtë:

a) Protokollin do të nënshkruhet nga Presidenti i Asamblesë dhe Sekretari i tij i Përgjithshëm.

b) Protokollin do të jetë i hapur për ratifikim nga çdo Shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventën në fjalë të Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

c) Instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

d) Protokollin do të hyjë në fuqi në lidhje me shtetet që e kanë ratifikuar atë, në datën në të cilën

instrumenti i njëqind e njëzet e tetë i ratifikimit është depozituar në këtë mënyrë.

e) Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë menjëherë të gjitha Shtetet Kontraktuese për datën e depozitimit të çdo ratifikimi të Protokollit.

f) Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë menjëherë të gjitha Shtetet Kontraktuese në Konventën në fjalë për datën në të cilën Protokollin hyn në fuqi.

g) Në lidhje me çdo Shtet Kontraktues që ratifikon Protokollin pas datës së lartpërmendur, Protokollin do të hyjë në fuqi pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit pranë Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Si rrjedhojë, në pajtim me veprimin e lartpërmendur të Asamblesë, ky Protokoll është hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës.

Në dëshmi të kësaj, Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i Sesionit të Tridhjetë e Nëntë të Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, duke u autorizuar nga Asambleja, nënshkruajnë këtë Protokoll.

Bërë në Montreal, në ditën e gjashtë të tetorit të vitit dy mijë e gjashtëmbëdhjetë, në një dokument të vetëm në gjuhët angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëloj autentik. Ky Protokoll do të mbetet i depozituar në arkivat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe kopjet e vërtetuara të tij do të transmetohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës tek të gjitha Shtetet Kontraktuese të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, bërë në Çikago, në ditën e shtatë të dhjetorit 1944.

Abdul Rahman

President i Sesionit të Tridhjetë e Nëntë

F. Liu

Sekretar i Përgjithshëm i Asamblesë



Doc 10077

PROTOCOL

RELATING TO AN AMENDMENT TO THE CONVENTION ON INTERNATIONAL CIVIL AVIATION

[Article 50(a)]

Signed at Montréal on 6 October 2016

PROTOCOLE

PORTANT AMENDEMENT DE LA CONVENTION RELATIVE À L'AVIATION CIVILE INTERNATIONALE

[Article 50 a)]

Signé à Montréal le 6 octobre 2016

PROTOCOLO

RELATIVO A UNA ENMIENDA DEL CONVENIO SOBRE AVIACIÓN CIVIL INTERNACIONAL

[Artículo 50 a)]

Firmado en Montreal el 6 de octubre de 2016

ПРОТОКОЛ,

КАСАЮЩИЙСЯ ИЗМЕНЕНИЯ КОНВЕНЦИИ О МЕЖДУНАРОДНОЙ ГРАЖДАНСКОЙ АВИАЦИИ

[статья 50 а)]

Подписан в Монреале 6 октября 2016 года

修订《国际民用航空公约》

[第五十条第一款]

议定书

2016年10月6日订于蒙特利尔

بروتوكول

بشأن تعديل اتفاقية الطيران المدني الدولي

[المادة ٥٠ أ)]

الموقع في مونتريال في ٦ أكتوبر/تشرين الأول ٢٠١٦



2016

INTERNATIONAL CIVIL AVIATION ORGANIZATION
ORGANISATION DE L'AVIATION CIVILE INTERNATIONALE
ORGANIZACIÓN DE AVIACIÓN CIVIL INTERNACIONAL
МЕЖДУНАРОДНАЯ ОРГАНИЗАЦИЯ ГРАЖДАНСКОЙ АВИАЦИИ
国际民用航空组织
منظمة الطيران المدني الدولي



Certified to be a true and complete copy

Copie certifiée conforme

Es copia fiel y auténtica

Копия точная и полная

经认证的真实和完整的副本

صورة معتمدة طبق الأصل

Director, Legal Affairs and External Relations Bureau

Directeur des affaires juridiques et des relations extérieures

Director de asuntos jurídicos y relaciones exteriores

Директор Управления по правовым вопросам и внешним сношениям

法律事务和对外关系局局长

مدير إدارة الشؤون القانونية والعلاقات الخارجية

ICAO OACI ИКАО 国际民航组织 الايكاو

PROTOCOL

RELATING TO AN AMENDMENT TO THE
CONVENTION ON INTERNATIONAL CIVIL AVIATION

[Article 50(a)]

Signed at Montréal on 6 October 2016



Published by ICAO under the authority of the Secretary General of the
INTERNATIONAL CIVIL AVIATION ORGANIZATION
999 Robert-Bourassa Boulevard, Montréal, Quebec, Canada H3C 5H7

For ordering information and for a complete listing of sales agents
and booksellers, please go to the ICAO website at www.icao.int

*Doc 10077, Protocol Relating to an Amendment to the Convention
on International Civil Aviation [Article 50(a)]*

Order Number: 10077

ISBN 978-92-9258-102-2

© ICAO 2016

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in a
retrieval system or transmitted in any form or by any means, without prior
permission in writing from the International Civil Aviation Organization.



PROTOCOL

RELATING TO AN AMENDMENT TO ARTICLE 50(a) OF THE CONVENTION ON INTERNATIONAL CIVIL AVIATION

Signed at Montréal on 6 October 2016

THE ASSEMBLY OF THE INTERNATIONAL CIVIL AVIATION ORGANIZATION

HAVING MET in its Thirty-ninth Session at Montréal on 1 October 2016,

HAVING NOTED that it is the desire of a large number of Contracting States to enlarge the membership of the Council in order to ensure better balance by means of an increased representation of Contracting States,

HAVING CONSIDERED it appropriate to increase the membership of that body from thirty-six to forty,

HAVING CONSIDERED it necessary to amend, for the purpose aforesaid, the Convention on International Civil Aviation done at Chicago on the seventh day of December 1944,

1. APPROVES, in accordance with the provisions of Article 94(a) of the Convention aforesaid, the following proposed amendment to the said Convention:

“In Article 50(a) of the Convention the second sentence shall be amended by replacing ‘thirty-six’ by ‘forty’.”;

2. SPECIFIES, pursuant to the provisions of the said Article 94(a) of the said Convention, one hundred and twenty-eight as the number of Contracting States upon whose ratification the proposed amendment aforesaid shall come into force;
3. RESOLVES that the Secretary General of the International Civil Aviation Organization draw up a Protocol, in the English, Arabic, Chinese, French, Russian and Spanish languages, each of which shall be of equal authenticity, embodying the amendment above-mentioned and the matter hereinafter appearing:
 - a) The Protocol shall be signed by the President of the Assembly and its Secretary General.
 - b) The Protocol shall be open to ratification by any State which has ratified or adhered to the said Convention on International Civil Aviation.



- c) The instruments of ratification shall be deposited with the International Civil Aviation Organization.
- d) The Protocol shall come into force in respect of the States which have ratified it on the date on which the one hundred and twenty-eighth instrument of ratification is so deposited.
- e) The Secretary General shall immediately notify all Contracting States of the date of deposit of each ratification of the Protocol.
- f) The Secretary General shall immediately notify all Contracting States to the said Convention of the date on which the Protocol comes into force.
- g) With respect to any Contracting State ratifying the Protocol after the date aforesaid, the Protocol shall come into force upon deposit of its instrument of ratification with the International Civil Aviation Organization.

CONSEQUENTLY, pursuant to the aforesaid action of the Assembly,

This Protocol has been drawn up by the Secretary General of the Organization.

IN WITNESS WHEREOF, the President and the Secretary General of the aforesaid Thirty-ninth Session of the Assembly of the International Civil Aviation Organization, being authorized thereto by the Assembly, sign this Protocol.

DONE at Montréal on the sixth day of October of the year two thousand and sixteen, in a single document in the English, Arabic, Chinese, French, Russian and Spanish languages, each text being equally authentic. This Protocol shall remain deposited in the archives of the International Civil Aviation Organization, and certified copies thereof shall be transmitted by the Secretary General of the Organization to all Contracting States to the Convention on International Civil Aviation done at Chicago on the seventh day of December 1944.

A. Abdul Rahman
*President of the Thirty-ninth Session
of the Assembly*

F. Liu
Secretary General

**PROTOKOLL**

NË LIDHJE ME NJË NDRYSHIM TË
NENIT 56 TË KONVENTËS SË
AVIACIONIT CIVIL NDËRKOMBËTAR
Nënshkruar në Montreal, më 6 tetor 2016

Kuvendi i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil,

duke u takuar në Sesionin e tij të Tridhjetë e Nëntë në Montreal, më 1 tetor 2016;

duke pasur parasysh se është dëshira e përgjithshme e Shteteve Kontraktuese për të zgjeruar anëtarësimin në Komisionin e Lundrimit Ajror;

duke e konsideruar atë të duhur për të rritur anëtarësimin e atij organi nga nëntëmbëdhjetë në njëzet e një; dhe

duke e konsideruar të nevojshëm ndryshimin, për qëllimin e lartpërmendur, të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, të bërë në Çikago në ditën e shtatë të dhjetorit 1944:

1. Miraton, në përputhje me dispozitat e nenit 94 (a) të Konventës së lartpërmendur, ndryshimin e propozuar në vijim të Konventës në fjalë:

“Në nenin 56 të Konventës shprehja “nëntëmbëdhjetë anëtarë” zëvendësohet me “njëzet e një anëtarë”.

2. Përcakton, në përputhje me dispozitat e nenit 94 (a) të kësaj Konvente, njëqind e njëzet e tetë si numrin e Shteteve Kontraktuese mbi ratifikimin e të cilave ndryshimi i lartpërmendur do të hyjë në fuqi; dhe

3. Vendos që Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil të hartojë një protokoll në gjuhët angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, secila prej të cilave do të jetë njëloj autentike, duke përfshirë edhe ndryshimin e lartpërmendur dhe çështjet që paraqiten më poshtë:

a) protokollin do të nënshkruhet nga Presidenti i Asamblesë dhe Sekretari i Përgjithshëm i tij;

b) protokollin do të jetë i hapur për ratifikim nga çdo shtet që ka ratifikuar ose aderuar në Konventën në fjalë të Aviacionit Civil Ndërkombëtar;

c) instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil;

d) protokollin do të hyjë në fuqi në lidhje me shtetet që e kanë ratifikuar atë në datën në të cilën instrumenti i njëqind e njëzet e tetë i ratifikimit është depozituar në këtë mënyrë;

e) Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë menjëherë të gjitha Shtetet Kontraktuese për datën e depozitimit të çdo ratifikimi të Protokollit;

f) Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë menjëherë të gjitha Shtetet Kontraktuese të Konventës në fjalë për datën në të cilën Protokollin hyn në fuqi;

g) në lidhje me çdo Shtet Kontraktues që ratifikon Protokollin pas datës së lartpërmendur, Protokollin do të hyjë në fuqi pas depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit pranë Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Si rrjedhojë, në pajtim me veprimin e lartpërmendur të Asamblesë, ky Protokoll është hartuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës.

Në dëshmi të kësaj, Presidenti dhe Sekretari i Përgjithshëm i Sesionit të Tridhjetë e Nëntë të sipërpërmendur të Asamblesë së Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil, duke qenë të autorizuar për këtë nga Asambleja, nënshkruajnë këtë Protokoll.

Bërë në Montreal, në ditën e gjashtë të tetorit të vitit dy mijë e gjashtëmbëdhjetë, në një dokument të vetëm në gjuhët angleze, arabe, kineze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku çdo tekst është njëloj autentik. Ky Protokoll do të mbetet i depozituar në arkivat e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe kopjet e vërtetuara të tij do të transmetohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës tek të gjitha Shtetet Kontraktuese të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, bërë në Çikago, në ditën e shtatë të dhjetorit 1944.

A. Abdul Rahman

President i Sesionit të Tridhjetë e Nëntë

F. Liu

Sekretar i Përgjithshëm të Asamblesë



Doc 10076

PROTOCOL

RELATING TO AN AMENDMENT TO THE CONVENTION ON INTERNATIONAL CIVIL AVIATION
[Article 56]

Signed at Montréal on 6 October 2016

PROTOCOLE

PORTANT AMENDEMENT DE LA CONVENTION RELATIVE À L'AVIATION CIVILE INTERNATIONALE
[Article 56]

Signé à Montréal le 6 octobre 2016

PROTOCOLO

RELATIVO A UNA ENMIENDA DEL CONVENIO SOBRE AVIACIÓN CIVIL INTERNACIONAL
[Artículo 56]

Firmado en Montreal el 6 de octubre de 2016

ПРОТОКОЛ,

КАСАЮЩИЙСЯ ИЗМЕНЕНИЯ КОНВЕНЦИИ О МЕЖДУНАРОДНОЙ ГРАЖДАНСКОЙ АВИАЦИИ
[статья 56]

Подписан в Монреале 6 октября 2016 года

关于修订《国际民用航空公约》
[第五十六条]

议定书

2016年10月6日订于蒙特利尔

بروتوكول

بشأن تعديل اتفاقية الطيران المدني الدولي

[المادة ٥٦]

الموقع في مونتريال في ٦ أكتوبر/تشرين الأول ٢٠١٦



2016

INTERNATIONAL CIVIL AVIATION ORGANIZATION
ORGANISATION DE L'AVIATION CIVILE INTERNATIONALE
ORGANIZACIÓN DE AVIACIÓN CIVIL INTERNACIONAL
МЕЖДУНАРОДНАЯ ОРГАНИЗАЦИЯ ГРАЖДАНСКОЙ АВИАЦИИ
国际民用航空组织
منظمة الطيران المدني الدولي



Certified to be a true and complete copy

Copie certifiée conforme

Es copia fiel y auténtica

Копия точная и полная

经认证的真实和完整的副本

صورة معتمدة طبق الأصل

Director, Legal Affairs and External Relations Bureau

Directeur des affaires juridiques et des relations extérieures

Director de asuntos jurídicos y relaciones exteriores

Директор Управления по правовым вопросам и внешним сношениям

法律事务和对外关系局局长

مدير إدارة الشؤون القانونية والعلاقات الخارجية

ICAO OACI ИКАО 国际民航组织 الايكاو

PROTOCOL

RELATING TO AN AMENDMENT TO THE
CONVENTION ON INTERNATIONAL CIVIL AVIATION

[Article 56]

Signed at Montréal on 6 October 2016



Published by ICAO under the authority of the Secretary General of the
INTERNATIONAL CIVIL AVIATION ORGANIZATION
999 Robert-Bourassa Boulevard, Montréal, Quebec, Canada H3C 5H7

For ordering information and for a complete listing of sales agents
and booksellers, please go to the ICAO website at www.icao.int

***Doc 10076, Protocol Relating to an Amendment to the Convention
on International Civil Aviation [Article 56]***

Order Number: 10076

ISBN 978-92-9258-101-5

© ICAO 2016

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced, stored in a
retrieval system or transmitted in any form or by any means, without prior
permission in writing from the International Civil Aviation Organization.



PROTOCOL

RELATING TO AN AMENDMENT TO ARTICLE 56 OF THE CONVENTION ON INTERNATIONAL CIVIL AVIATION

Signed at Montréal on 6 October 2016

THE ASSEMBLY OF THE INTERNATIONAL CIVIL AVIATION ORGANIZATION

HAVING MET in its Thirty-ninth Session at Montréal on 1 October 2016,

HAVING NOTED that it is the general desire of Contracting States to enlarge the membership of the Air Navigation Commission,

HAVING CONSIDERED it proper to increase the membership of that body from nineteen to twenty-one, and

HAVING CONSIDERED it necessary to amend, for the purpose aforesaid, the Convention on International Civil Aviation done at Chicago on the seventh day of December 1944,

1. APPROVES, in accordance with the provisions of Article 94(a) of the Convention aforesaid, the following proposed amendment to the said Convention:

“In Article 56 of the Convention the expression ‘nineteen members’ shall be replaced by ‘twenty-one members’.”;

2. SPECIFIES, pursuant to the provisions of the said Article 94(a) of the said Convention, one hundred and twenty-eight as the number of Contracting States upon whose ratification the aforesaid amendment shall come into force; and
3. RESOLVES that the Secretary General of the International Civil Aviation Organization shall draw up a Protocol, in the English, Arabic, Chinese, French, Russian and Spanish languages, each of which shall be of equal authenticity, embodying the amendment above-mentioned and the matters hereinafter appearing:
 - a) The Protocol shall be signed by the President of the Assembly and its Secretary General.
 - b) The Protocol shall be open to ratification by any State which has ratified or adhered to the said Convention on International Civil Aviation.
 - c) The instruments of ratification shall be deposited with the International Civil Aviation Organization.



- d) The Protocol shall come into force in respect of the States that have ratified it on the date on which the one hundred and twenty-eighth instrument of ratification is so deposited.
- e) The Secretary General shall immediately notify all Contracting States of the date of deposit of each ratification of the Protocol.
- f) The Secretary General shall immediately notify all Contracting States to the said Convention of the date on which the Protocol comes into force.
- g) With respect to any Contracting State ratifying the Protocol after the date aforesaid, the Protocol shall come into force upon deposit of its instrument of ratification with the International Civil Aviation Organization.

CONSEQUENTLY, pursuant to the aforesaid action of the Assembly,

This Protocol has been drawn up by the Secretary General of the Organization.

IN WITNESS WHEREOF, the President and the Secretary General of the aforesaid Thirty-ninth Session of the Assembly of the International Civil Aviation Organization, being authorized thereto by the Assembly, sign this Protocol.

DONE at Montréal on the sixth day of October of the year two thousand and sixteen, in a single document in the English, Arabic, Chinese, French, Russian and Spanish languages, each text being equally authentic. This Protocol shall remain deposited in the archives of the International Civil Aviation Organization, and certified copies thereof shall be transmitted by the Secretary General of the Organization to all Contracting States to the Convention on International Civil Aviation done at Chicago on the seventh day of December 1944.

A. Abdul Rahman
*President of the Thirty-ninth Session
of the Assembly*

F. Liu
Secretary General



DEKRET

Nr. 243, datë 28.6.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 62/2024, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për ndryshimin e nenit 50 (A) të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar, si dhe në protokollin për ndryshimin e nenit 56 të Konventës së Aviacionit Civil Ndërkombëtar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 59/2024

**PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTLIGJIT “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN
NR. 45/2016, ‘PËR VULLNETARIZMIN’”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 38, pika 6, e 55, pika 3, të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 45/2016 ‘Për vullnetarizmin’”, nismë deputetësh.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 27.6.2024.

VENDIM

Nr. 60/2024

**PËR RRËZIMIN E LISTËS SË PARË NË
BLLOK TË KANDIDATËVE TË
PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR NGA
RADHËT E AVOKATËVE, SIPAS LIGJIT
NR. 115/2016, “PËR ORGANET E
QEVERISJES SË SISTEMIT TË
DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së parë në bllok të kandidatëve për anëtarë nga radhët e avokatëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Artan Reçi
2. Albens Tabaku

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 27.6.2024.

**VENDIM
Nr. 61/2024****PËR RRËZIMIN E LISTËS SË PARË NË
BLLOK TË KANDIDATËVE TË
PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË NGA RADHËT E
AVOKATËVE, SIPAS LIGJIT NR. 115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË
SISTEMIT TË DREJTËSISË”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së parë në bllok të kandidatëve për anëtarë nga radhët e avokatëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Saimir Kola
2. Erind Mërkuri

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 27.6.2024.

REZOLUTË**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2023****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur e vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për sigurimin dhe kompensimin e depozitave të qytetarëve, të vendosura në bankat që operojnë në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar kontributin e saj në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë së sistemit financiar e bankar;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë agjenci, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e saj me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave gjatë vitit 2023 në drejtim të:

Mbështetjes së procesit të integritetit evropian, si pjesë e grupit negociator për kapitullin 9 “Shërbimet financiare”, duke dhënë kontributin e saj gjatë shqyrtimit analitik dhe nivelit të përputhshmërisë së legjislacionit vendas me atë të BE-së.

Zbatimit me përpikëri të Planit të Verifikimeve, duke kryer 5 verifikime të plota me bankat dhe 6 verifikime të plota me SHKK-të, si dhe duke përditësuar rekomandimet me afate të përcaktuara, të adresuara për subjektin përkatës, sipas raportit të fundit të verifikimit.

Intensifikimit të mjeteve të komunikimit për të rritur nivelin e informimit dhe ndërgjegjësimin të publikut për përfitimet e skemës së sigurimit të depozitave, në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë, Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe botën akademike.

Shkëmbimit të ndërsjellët dhe të vazhdueshëm të përvojave me shoqatat e sigurimit të depozitave dhe organizmat ndërkombëtarë, duke marrë pjesë në aktivitete për trajnimin e stafit, veçanërisht në drejtim të adoptimit të teknologjisë më të fundit në infrastrukturën e kompensimit.

Përmirësimit të sistemit të teknologjisë së informacionit, ku në bashkëpunim me kompaninë e përzgjedhur nga BERZH-i është kryer implementimi i moduleve, të cilat automatizojnë procesin, në rast ngjarjeje siguri, ku përfshihet edhe moduli i përpunimit të ankimeve të depozituesve.

Kuvendi rekomandon që Agjencia e Sigurimit të Depozitave për vitin 2024 të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. Të intensifikojë punën në drejtim të sigurimit të gatishmërisë institucionale për kompensimin efektiv të depozituesve nëpërmjet ushtrimit të testimeve, të simulimeve teknike dhe bashkëpunimit me bankat dhe SHKK-të anëtare të skemës në këtë drejtim.

2. Të kontribuojë në avancimin e skemës së sigurimit të depozitave duke e përafruar brenda vitit 2024 kuadrin rregullator me skemat evropiane të



sigurimit të depozitave, përmes adresimit të çështjeve që nuk përputhen me direktivën 2014/49/BE “Për skemat e garantimit të depozitave”.

3. Të rrisë transparencën përmes publikimit të të dhënave dhe raporteve statistikore në formate dhe platforma lehtësisht të përdorshme nga publiku i gjerë.

4. Të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë dhe palët e tjera të përfshira në proces me qëllim identifikimin dhe administrimin e rreziqeve kibernetike.

5. Të bashkëpunojë me Bankën e Shqipërisë për harmonizimin e praktikave të ndërveprimit në funksion të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 27.6.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke vlerësuar si një arritje të rëndësishme bërjen operationale dhe fillimin nga puna të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., në datë 12.4.2023, si dhe rritjen graduale të numrit të anëtarëve të regjistruar të bursës;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm miratimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili përmirëson kuadrin rregullator bazë ligjor të energjisë së rinovueshme në Shqipëri, përafron legjislacionin shqiptar me *acquis* e BE-së, duke synuar ndër të tjera edhe rritjen e diversifikimit të burimeve të energjisë dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, i cili vijon të ketë një rënie nga viti në vit, humbjet e energjisë elektrike për vitin 2023 arritën në nivelin 18.93%, duke shënuar një ulje të mëtejshme krahasuar me vitin 2022 (19.7%), ndërkohë niveli total i arkëtimeve për vitin 2023 arriti shifrat 99.4%, duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2022 (98%);

Vlerëson për vitin 2023:

- Punën e ERE-s në publikimet e vazhdueshme në rrjetet sociale për veprimtarinë e institucionit, si dhe informacione të nevojshme për konsumatorët për të drejtat e tyre apo mesazhe sensibilizuese për kursimin e energjisë elektrike, broshura informative për konsumatorin, si dhe informacione të tjera që i shërbejnë konsumatorit.

- Punën e bërë nga ERE-ja lidhur me implementimin e Platformës së Krahasimit të Çmimeve (PCT), si një hap i rëndësishëm drejt promovimit të një tregu konkurrues e alternativ të çmimeve të furnizimit me energji elektrike për të gjithë ata konsumatorë të cilët kanë plotësuar kriteret ligjore të daljes në treg të lirë.

- Punën e bërë nga ERE-ja duke miraturar gjatë vitit 2023 vendime të rëndësishme për krijimin e një tregu funksional gazi, i cili shfrytëzon potencialin e infrastrukturës ekzistuese në vend dhe që krijon bazat për planet e zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës.

- Punën dhe bashkëpunimin nga ana e ERE-s për të bërë të mundur që nga data 1 janar 2024 të gjithë klientët e lidhur në 20 kV të furnizohen në treg të liberalizuar.

- Punën e bërë nga ERE-ja për nënshkrimin e *Memorandum of Understanding* (MOU) me përfaqësues të Entit Rregullator të Italisë, Maqedonisë së Veriut, Greqisë për bashkimin e tregjeve të ditës në avancë brenda vitit 2026.

- Punën e bërë nga ERE-ja në kuadër të forcimit të standardeve të sigurisë kibernetike për vetë rregullatorin, duke përmbyllur me sukses procedurën me objekt “Përmirësimi i mbrojtjes dhe sigurisë së rrjetit të ERE-s dhe implementimi i *firewall*”.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2024 i rekomandon ERE-s:

1. Të japë kontributin e saj dhe të luajë një rol proaktiv për të bërë të mundur rritjen e volumit të tregtuar në bursë dhe pjesëmarrjen e aktorëve të



rëndësishëm në fushën e energjisë, si dhe të vijojë punën për realizimin e bashkimit të tregjeve të energjisë së një dite më parë si një sfidë e rëndësishme, e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e eficiencës së impianteve të prodhimit të energjisë së rinovueshme të Shqipërisë në tregun rajonal dhe më gjerë.

2. Në kuadër të rritjes së sigurisë kibernetike, nga njëra anë, të monitorojë nivelin e implementimit të Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturave Kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët, si dhe shtrirjen e saj edhe në sektorin e gazit natyror dhe, nga ana tjetër, të bashkëpunojë me AKCESK-në për ndryshimet e nevojshme ligjore dhe përfshirjen e infrastrukturave kritike të energjisë.

3. Gjatë miratimit të planit të investimeve të shoqërive t'u kushtojë vëmendje të veçantë investimeve në zonat turistike të vendit, zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit, për më tepër, duke pasur parasysh ritmet me të cilat po rritet numri i turistëve në vend, duhet të shoqërohet edhe me investime në fushën e energjisë.

4. Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të tij, kërkesë edhe në progresraportin e KE-së, të shfrytëzojë Shkollën Ballkanike të Energjisë, e cila tashmë është funksionale, për shkëmbimin e eksperiencave midis rregullatorëve lidhur me problematikat që lidhen me bashkimin e tregjeve apo dhe problematika e sfida të tjera në fushën e energjisë.

5. Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe duke iu referuar praktikave më të mira të vendeve fqinje, si: Italia dhe Greqia, të punojë për krijimin e lehtësirave të mëtejshme në instalimin e paneleve fotovoltaike nga përdoruesit e energjisë elektrike.

6. Të vijojë të ketë në fokus të punës së tij dhe të rrisë përpjekjet në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit në rastet kur këto të fundit përballen me mbifaturim, keqfaturim/faturim aforfe, dëm ekonomik e tarifim i gabuar nga ana e operatorit të shpërndarjes apo edhe ngarkimit pa të drejtë me përgjegjësi të konsumatorëve kur konstatohen ndërhyrje apo dëmtime të matësve të vendosur në ambiente të përbashkëta.

7. Të japë kontributin e nevojshëm për ndryshimet ligjore në ligjin e energjisë për transpozimin e paketës së re të legjislacionit evropian në sektorin e energjisë elektrike.

8. Si pjesë e grupit ndërinstitucional të punës, të vijojë të japë kontributin e saj për hartimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës 2020–2030, siç kërkohet edhe nga progresraporti i KE-së.

9. Të vijojë punën për miratimin e akteve nënligjore të nevojshme për vendosjen e detyrimit të përdorimit të Platformës së Krahimit të Çmimeve (PCT) në tregun e lirë, si dhe të zhvillojë fushata promovuese mbi modalitetet e funksionimit të saj.

10. Pas vlerësimit që do të bëjë Grupi i Punës, të marrë masat e nevojshme për adresimin e pengesave të mundshme të diversifikimit të prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë të miratojë aktet rregullatore që dalin si detyrim i ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, për të nxitur më tej shfrytëzimin e burimeve diellore dhe të erës në funksion të diversifikimit të burimeve të energjisë, duke e bërë sistemin më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve klimatike.

11. Të punojë për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale me Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, marrëveshje e cila, në kuadër të adresimit të sfidave të përbashkëta, të ketë në fokus të saj hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme për adresimin e çështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit eficient të energjisë.

12. Të vijojë bashkëpunimin me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë për mundësitë e rritjes së kapacitetit transmetues të TAP Ag në nivel rajonal.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 27.6.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AKEP-in si autoritet të pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet



interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke theksuar rëndësinë e rritjes dhe përmirësimit të sigurisë kibernetike, mbikëqyrjen rregullatore të qëndrueshmërisë, pacenueshmërisë dhe integritetit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në vend;

Duke theksuar se projektligji i ri “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, krahas përafrimit të mëtejshëm me direktivën (EU) 2018/1972 dhe arritjen e objektivit strategjik për një shoqëri gigabit, parashikon edhe rritjen e pavarësisë financiare dhe funksionale të AKEP-it;

Duke theksuar rëndësinë e sigurimit të një kuadri rregullator të favorshëm për hyrjen e MVNO-ve në treg, bazuar në praktikat më të mira evropiane;

Vlerëson për vitin 2023:

- Punën e bërë nga AKEP-i duke kërkuar marrjen e masave shtesë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të bërë të mundur garantimin e integritetit dhe pacenueshmërinë e rrjeteve të tyre, bashkëpunimin me AKCESK-në, si dhe investimet të cilat janë bërë nga AKEP-i gjatë vitit 2023, për të rritur nivelin e sigurisë për infrastrukturën dhe sistemet kritike që vetë AKEP-i ka implementuar, mirëmban dhe administron.

- Kontributin e AKEP-it në hartimin e projektligjit të ri “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ndër të tjera synon përafrim të mëtejshëm me direktivën (EU) 2018/1972, si dhe arritjen e objektivit strategjik për një shoqëri gigabit, përmes mundësimit të zhvillimit të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë.

- Punën e bërë nga AKEP-i në kuadër të luftës kundër informalitetit në tregun e shërbimeve postare, duke bërë të mundur evidentimin dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të shkelësve, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në këtë sektor dhe ndërgjegjësimin e subjekteve në përmbushjen e rregullave dhe standardeve ligjore të vendosura.

- Punën e bërë nga AKEP-i dhe bashkëpunimin me AMA-n për marrjen e masave lidhur me fenomenin e piraterisë online, të operatorëve piratë që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme, duke ofruar produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s.

- Punën e bërë nga AKEP-i dhe bashkëpunimin me institucionet përkatëse në kuadër të Grupit

Ndërinstitucional të Punës “Për ngritjen dhe funksionimin e numrit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112”. Bërja funksionale e numrit të emergjencës 112 në të gjithë vendin është theksuar në mënyrë të përsëritur edhe në progresraportet e KE-së.

- Punën e bërë nga AKEP-i si pjesë aktive e grupit ndërinstitucional të punës për lirimin e brezit digjital dividend dy (DD2) duke paraqitur pozicionimin e sipërmarrësve lidhur me brezin 700 MHz, si dhe informacionet e nevojshme lidhur me pritshmëritë e tregut celular për rrjetet 5G.

- Punën e AKEP-it si pjesë raportuese e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE).

Kuvendi për vitin 2024 rekomandon:

1. Analiza e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme duhet të realizohet periodikisht siç kërkohet në ligj dhe të ketë si synim nga njëra anë përmirësimin dhe nxitjen e konkurrencës efektive në tregun e komunikimeve elektronike mobile, duke trajtuar edhe futjen në treg e MVNO-ve, prezenca e të cilëve do të ishte një faktor i rëndësishëm në nxitjen dhe rritjen e konkurrencës në këtë treg dhe nga ana tjetër propozimin e masave rregulluese të nevojshme për sipërmarrësit e shpallur me fuqi të ndjeshme në këtë treg.

2. AKEP-i gjatë vitit 2024 krahas proceseve të monitorimit/inspektimit të zbatimit nga operatorët të detyrimeve dhe rekomandimeve të lëna në inspektimet e mëparshme, të rishikojë Rregulloren e Portabilitetit duke synuar përmirësimin e procesit të portimit, veçanërisht përmes vendosjes së detyrimeve dhe përgjegjësisë edhe për operatorin dhënës për informim të pajtimtarit për arsyet e refuzimit të kërkesës për portim.

3. AKEP-i, duke marrë shkas edhe nga sulmi kibernetik ndaj sistemeve të një prej kompanive celulare në vend, të kërkojë marrjen e masave shtesë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike për të bërë të mundur garantimin e integritetit dhe pacenueshmërinë e rrjeteve dhe infrastrukturave kritike të tyre, si dhe ruajtjen e të dhënave personale të përdoruesve të tyre.

4. Krahas analizës së tregjeve me shumicë të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme, AKEP-i, duke iu referuar edhe praktikave më të mira evropiane, të kryejë një studim për vlerësimin e mundësive dhe impaktit të hyrjes së MVNO-ve në



tregun e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme, si dhe sigurimin e një kuadri rregullator të favorshëm për hyrjen e MVNO-ve në treg, në përputhje edhe me rekomandimin e AK-së për AKEP-in.

5. AKEP-i gjatë inspektimeve që do të zhvillojë pranë ofruesit të shërbimit universal “Posta Shqiptare” të vijojë të kërkojë përmbushjen e detyrimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit krahas implementimit të projektit për vendosjen e kutive postare pranë degëve të postës me kod unik, ku qytetarët mund të tërheqin pakot në çdo orë nëpërmjet një kodi specifik, duke evituar edhe qëndrimet në radhë të qytetarëve për tërheqjen e pakove, problem i cili është bërë shqetësues veçanërisht në Tiranë.

6. AKEP-i të vijojë të monitorojë me rigorozitet ecurinë e mbulimit me shërbim celular të akseve rrugore të vendit duke kërkuar nga të dy operatorët implementimin e stacioneve të reja të dedikuara të parashikuara për vitin 2023, si dhe afate të sakta për ndërtimin e stacioneve të reja të dedikuara të parashikuara për vitin aktual dhe në vijim, mbulimi me shërbim celular të akseve rrugore të vendit, si dhe i zonave turistike duhet të jetë prioritet i punës së AKEP-it për më tepër kur pritet që numri i turistëve të jetë në rritje.

7. Pas miratimit të ligjit të ri për komunikimet elektronike, AKEP-i të marrë masat e nevojshme për miratimin në një kohë sa më të shkurtër të akteve të reja rregullatore në mënyrë të veçantë miratimin brenda vitit 2024 të metodologjisë për përlllogaritjen e masës së gjobave, si dhe procedurën e veprimtarisë inspektuese në zbatim të ligjit të ri.

8. AKEP-i të miratojë për këshillim publik dokumentin “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit të brezit të frekuencave 3400–3800 MHz”, me qëllim dhënien brenda vitit 2024 e të drejtave të përdorimit për ndërtimin e rrjeteve të gjeneratës së pestë celulare (5G), të cilët kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 27.6.2024.

URDHËR

Nr. 473, datë 24.6.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtura termikisht.

Nga shteti i Italisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Sardegna	Cagliari	Cagliari
2	Veneto	Padua	Casale Di Scodosia
3	Veneto	Verona	Bonavigo
4	Veneto	Verona	Minerbe
5	Emilia-Romagna	Bologna	Crevalcore

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtura termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.



4. Urdhri nr. 268, datë 8.4.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 474, datë 24.6.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, të tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3	*Bashkia/fshat/provincë
1	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*	
2	Małopolskie	Gorlice	Bobowa	Bobowa
3	Mazowieckie	Siedlce	Paprotnia*	

4	Łódzkie	Skieriewice	Maków*	
5	Łódzkie	Łęczyca	Łęczyca (rural)*	
6	Łódzkie	Łask	Sędziszewice*	
7	Zachodniopomorskie	Police	Kolbaskowo*	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 192, datë 13.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 475, datë 24.6.2024

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR.
780, DATË 29.12.2023, “PËR DISA MASA
MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të



ndryshuar, dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 780, datë 29.12.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Holandës”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 476, datë 24.6.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenet 42 dhe 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre duke përfshirë mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Baden-Württemberg	Emmendingen	Nördlicher Kaiserstuhl
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Großräschen
Brandenburg	Oberspreewald-Lausitz	Ruhland
Brandenburg	Oder-Spree	Scharmützelsee
Brandenburg	Spree-Neiße	Drebkau
Brandenburg	Uckermark	Gartz (Oder)
Brandenburg	Uckermark	Angermünde
Brandenburg	Uckermark	Prenzlau
Brandenburg	Dahme-Spreewald	Lübben (Spreewald)
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Parchimer Umland
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Eldenburg Lütz
Mecklenburg-Vorpommern	Ludwigslust-Parchim	Grabow
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Krakow am See
Niedersachse	Emsland	Twist
Niedersachsen	Emsland	Emsbüren
Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel
Sachsen	Bautzen	
Sachsen	Görlitz	Weißwasser/O.L.
Sachsen	Görlitz	Diehsa
Sachsen	Görlitz	Bad Muskau
Sachsen	Görlitz	Rietschen
Sachsen	Görlitz	Markersdorf
Sachsen	Görlitz	Boxberg/O.L.
Sachsen	Görlitz	Schleife
Sachsen	Görlitz	Niesky
Sachsen	Görlitz	Bernstadt/Schönau-Berzdorf
Sachsen	Görlitz	Diehsa
Sachsen	Görlitz	Reichenbach/O.L.
Sachsen	Görlitz	Ostritz
Sachsen	Görlitz	Weißer Schöps/Neiße
Sachsen	Görlitz	Görlitz
Sachsen	Meißen	Thiendorf
Sachsen	Meißen	Ebersbach
Sachsen	Meißen	Moritzburg
Sachsen	Meißen	Schönfeld
Sachsen	Meißen	Radeburg
Sachsen	Meißen	Weinböhla
Sachsen	Meißen	Niederau
Sachsen	Nordsachsen	Wermisdorf
Sachsen	Sächsische Schweiz - Osterzgebirge	Lohmen/Stadt Wehlen
Sachsen	Bautzen	Radibor
Sachsen	Bautzen	Königswartha
Sachsen	Bautzen	Neschwitz
Sachsen	Bautzen	Elsterheide*
Sachsen	Bautzen	Spreetal*
Schleswig-Holstein	Nordfriesland	Südtondern
Schleswig-Holstein	Kiel	Kiel

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të



kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Gjermanisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.2. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të

OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.2. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç. janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.3. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin



6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

2.4. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenin 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.6. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenin 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të

derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim virusit të murtajes afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 100, datë 14.2.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 477, datë 24.6.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, neni 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, duke përfshirë mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Borsod-Abaúj-Zemplén	Gönc*	
Budapest	Budapest*	
Heves	Pétersvárad*	
Heves	Eger*	
Jász-Nagykun-Szolnok	Tiszafehérvár*	
Nógrád	Balassagyarmat*	
Nógrád	Salgótarján*	
Nógrád	Rétság*	
Pest	Pilisvörösvár*	
Pest	Budaörs*	
Pest	Szentendre*	
Pest	Ráckeve*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Vásárosnamény*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Nyírbátor*	
Szabolcs-Szatmár-Bereg	Nagykálló*	
Komárom-Esztergom	Esztergom*	
Komárom-Esztergom	Dorog*	
Komárom-Esztergom	Tatabánya*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Hungarisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8.

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muajt para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërtetohet se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muajt, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;



b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit.

b) Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

c) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

d) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e



përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 206, datë 21.3.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajës Afrikane të Derrave të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 478, datë 24.6.2024

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E UKRAINËS**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të

mbajtur, produkteve të tyre duke përfshirë mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe e ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Chemihiv	Ripkyns'kyi*	
Chemihiv	Nizhyns'kyi*	
Chemihiv	Kozelets'kyi*	
Chemihiv	Prlyuts'kyi*	
Chemihiv	Nosivs'kyi	
Chemivtsi	Hlybots'kyi*	
Chemivtsi	Zastavnets'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'kyi*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolaevs'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Volyn	Kivertsivs'kyi*	
Poltava	Kobeliat's'kyi*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, produkteve të tyre, mishin e vulosur në një kontejner hermetik me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart dhe xhelatinën, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të pa infektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;



b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vjetët e fundit.

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;



b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur

kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 340, datë 10.5.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 2, datë 3.4.2024

PËR SHPREHJEN E DAKORDËSISË MBI
CAKTIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMEVE NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, dhe të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave, në mbledhjen e datës 3 prill 2024,

VENDOSI

1. Shprehjen e dakordësisë mbi propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për vendosjen e tarifave të shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, si më poshtë:



- Dhënien me qira të teatrit veror me tarifë 5.000 lekë/orë dhe falas për rastet kur ka marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për kryerjen e aktiviteteve edukuese ose kur Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është bashkorganizatore.

- Çmimet e biletave për hyrjen në muzeun arkivor të jenë:

- bileta individuale: 400 lekë;

- bileta në grup (grupi mbi 12 veta): 250 lekë;

- biletë e reduktuar për (pensionistët, jetimet e kujdestarët e tyre ligjor, invalidët): 100 lekë;

- falas për studentët e pajisur me karta studenti.

- Ekspozita të individualizuara: 10.000 lekë.

- Salla e leksioneve 5.000 lekë/orë dhe falas për rastet kur ka marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave për kryerjen e aktiviteteve edukuese ose kur Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është bashkorganizatore.

- Për tarifatat e riprodhimeve të dokumenteve arkivore në suport joletër (suvenir):

Përshkrimi i artikujve	Çmimet e ofertuara me TVSH sipas MK-së	Çmimet e shitjes që propozohen	Marzhi fitimit
Medaljon varëse qafe + kuti druri (figura 1)	2,774.4	3,329.28	20%
Pllakatë druri + kuti (figura 2)	3,428.4	4,114.08	20%
Pllakatë inoks + mbajtëse kastori (figura 3)	2,836.8	3,404.16	20%
Tablo për t'u varur në mur me motiv (figura 4)	2,346	2,815.20	20%
Puzzle (formuese) A4 + kuti (figura 5)	1,446	1,735.20	20%
Puzzle (formuese) A5 + kuti+ top (figura 6)	2,170.8	2,604.96	20%
Set: pulla/ butona këmishe, kravatë (figura 7)	11,084.4	13,301.28	20%
Set zyre: USB druri, mbajtëse kartëvizitash, bllok shënimesh, mouse pad (tapet) (figura 8)	5,742.00	6,890.40	20%
Set stilolapsash me motiv si shembull firmën e Ismail Qemalit (figura 9)	3,614.40	4,337.28	20%
Pergamene + kuti me motiv fragment nga fermanët (figura 10)	2,466.00	2,959.20	20%
Set, çadër, shall, kapuç, bluzë (figura 11)	4,142.40	4,970.88	20%
Set filxhani kafe (4 copë) me motiv (figura 12)	2,954.40	3,545.28	20%
Filxhan kafeje-çaji 300 ml me motiv (figura 13)	1,694.40	2,033.28	20%
Çakmak gold (figura 14)	1,980.00	2,376.00	20%
Set 3 në 1 (dam, shah, tavëll, mos u nxe) me motiv (figura 15)	4,508.40	5,410.08	20%
Kuba druri, gërmat e alfabetit + numra (figura 16)	2,487.60	2,985.12	20%
Aksesor telefoni (figura 17)	1,574.40	1,889.28	20%
Portofol (figura 18)	3,290.40	3,948.48	20%
Kuti me magnete sipas pulla të ndryshme historike (figura 19)	3,028.80	3,634.56	20%
Medaljon argjendi + kuti (figura 20)	81,820.80	98,184.96	20%
Medaljon argjendi (larje floriri) + kuti (figura 21)	56,383.20	67,659.84	20%
Pllakatë mermeri me gravure me motiv pjese nga deklarata e pavarësisë (figura 22)	3,307.20	3,968.64	20%
Bllok shënimesh A6 lëkurë (figura 23)	6,663.60	7,996.32	20%
Bllok shënimesh A5 lëkurë (figura 24)	3,169.20	3,803.04	20%
Orë muri (figura 25)	3,789.60	4,547.52	20%
Set zyre: dy stilolaps dhe hapesë letre (figura 26)	4,867.20	5,840.64	20%
Set vere + shah (figura 27)	5,949.60	7,139.52	20%
Përparëse kuzhine (figura 28)	2,008.80	2,410.56	20%
Lojë jenga (figura 29)	1,758.00	2,109.60	20%
Stilolaps "penë"+ bojë + kuti (figura 30)	4,766.40	5,719.68	20%
Power bank wireless (figura 31)	3,322.80	3,987.36	20%
Kufje wireless (figura 32)	5,702.40	6,842.88	20%
Power bank (figura 33)	4,747.20	5,696.64	20%
Portofol për kartëvizita + kuti (figura 34)	4,494.00	5,392.80	20%
Çantë- backpack (figura 35)	5,110.80	6,132.96	20%
Riprodhimi i kalendarit të Hasan Tahsinit (figura 36)	1,888.80	2,266.56	20%
Riprodhim maketi sipas origjinalit, motivi një pjesë e Kodikut (maketi i kinezeve) (figura 37)	990,336.00	1,188,403.20	20%
Kodiku i printuar në plexiglass (figura 38)	3,177.60	3,813.12	20%
Set zyre: bllok (notebook, karikues wireless) gotë për pije (kafe, çaj (figura 39))	7,264.80	8,717.76	20%
Riprodhim i argjenditë i kodikut (figura 40)	2,010,576.00	2,412,691.20	20%
Riprodhim i kodikut në bronz (figura 41)	1,981,848.00	2,378,217.60	20%

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido

**VENDIM****Nr. 110, datë 10.6.2024****PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLAT
E TREGUT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, TË MIRATUARA ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 347, DATË 27.12.2022**

Në mbështetje të neneve 16, 18, pika 1, germa “a” dhe “dh”, 19, germa “a”, 57 dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, me nr. 686/1 prot., datë 7.6.2024, “Për një ndryshim në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi të miratojë Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX-it, përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedurat e klerimit dhe shlyerjes).

- Me vendimin nr. 106, datë 23.3.2023, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë disa shtesa në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, me qëllim saktësimin e disa prej procedurave përfshirë dhe anekset përkatëse.

· Në vijim, shoqëria “ALPEX” sh.a., me shkresën nr. 329 prot., datë 11.9.2023, ka paraqitur pranë ERE-s propozimin për disa ndryshime në aneksin nr. 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 23.3.2023, “Mbi miratimin e disa shtesave në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022”.

- Në vijim të komunikimeve ndërmjet ERE-s dhe shoqërisë “ALPEX” sh.a., me qëllim qartësimin e propozimit, lidhur me nevojën për ndryshimet e aneksit nr. 3 të Rregullave të Tregut, shoqëria “ALPEX” sh.a. ka argumentuar dhe ka bërë me dije se, pas një analize të mirëfilltë, e cila përmbush kërkesat rregullatore, paraqet një kërkesë të re për ndryshimin e këtij aneksi, duke theksuar se:

“Me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 46, datë 31.1.2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 456, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, ‘Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike’”, është parashikuar se volumet me çmim të rregulluar, të cilat do të tregtohen midis kompanive publike të sistemit elektroenergjitik dhe operatorëve privatë mund të tregtohen nga ALPEX nëpërmjet instrumentit financiar. Këto volume do të tregtohen si kontrata financiare, ku ALPEX-i ka detyrimin të garantojë livrimin e volumeve përkatëse. Në këto kushte, ALPEX-i propozon disa ndryshime në propozimin për Portofolat e Anëtarëve të Bursës, që do trajtohen me Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje), duke i dhënë këtyre kontratave prioritetin e parë, si dhe duke parashikuar hapat që do të ndërmerren për të eliminuar rreziqet e mundshme, të tilla si mekanizmi i deklarimit paraprak për portofolat çift të këtyre kontratave, monitorimi i ALPEX-it kundrejt volumeve të deklaruar që rrjedhin nga këto kontrata, si dhe e drejta e ALPEX-it për të refuzuar urdhërporositë në shkelje të këtyre kontratave, referuar seksionit F.2.6 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme.”.

- ERE ka konstatuar se ndryshimet e propozuara për miratim nga shoqëria “ALPEX” sh.a., rezultojnë në mënyrën e renditjes, për sa i përket sasive të energjisë elektrike të ofertuara nëpërmjet Portofolave si Urdhërporosi PPT, bazuar në kontratat e brendshme afatgjata OTC midis blerësve dhe shitësve, do të tregtohen në ALPEX si kontrata tip financiare, të miratuara nga ERE, sipas parashikimeve në Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike dhe ndryshimeve të miratuara me VKM-në nr. 46/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 456, datë 29.6.2022 të Këshillit të



Ministrave, 'Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike'".

- Gjithashtu, në këtë aneks janë përcaktuar dhe disa procedura teknike për mënyrën e realizimit të këtyre transaksioneve, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e tregtimit të këtyre kontratave financiare në bursë. Më tej, vijojnë të jenë të grupuara me përparësi në kurbën e blerjeve sasitë e energjisë elektrike të ofertuara nga "OST" sh.a. dhe "OSSH" sh.a., të vendosura si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Blerjeje për blerjen e humbjeve respektive të energjisë elektrike në treg të lirë. Për sa i përket Portofolave të Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi Shitjeje sipas prioriteteve, vërehet se pikat 2 dhe 4 janë bashkuar në një të vetme si "sasia e energjisë elektrike e ofertuar nga entiteti që do të luajë rolin e operatorit të burimeve të rinovueshme (REO) e vendosur si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje", e cila do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të shitjeve.

- Ndryshimet e propozuar janë të njëjta me sa parashikuar në VKM-në nr. 46/2024. Në këtë kuptim, është vlerësuar të vijohet me miratimet e ndryshimeve të aneksit 3, për atë kohë sa palët e interesuara janë njohur me përmbajtjen e VKM-së më herët dhe nuk kanë shprehur komente apo kundërshtime në procesin e miratimit të VKM-së së sipërcituar.

- Gjithashtu, në përputhje me memorandumin e mirëkuptimit të WB6, në datën 21 tetor 2021, ERE, Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRE), së bashku me Operatorët e Sistemit, Transmetimit të Shqipërisë (OST) dhe të Kosovës (KOSTT), me mbështetjen e USAID-it, kanë nënshkruar marrëveshjen kuadër (kornizë) për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, të nevojshme për operimin e bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë dhe atë Brenda së Njëjtës Ditë, ju bëjmë me dije se: "Propozimi për aprovim, lidhur me përcaktimin e Portofolave të Anëtarëve të Bursës që do trajtohen me Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi (Shitjeje/Blerjeje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në Tregjet e Ankandeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë

Elektrike - ALPEX sh.a." është miratuar dhe nga Bordi i ZRRE-së me vendimin nr. 1768_2023, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike të Republikës së Kosovës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, të ndryshuara si më poshtë vijon:

"ANEKS nr. 3 – Portofolat e Anëtarëve të Bursës që do trajtohen me Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi (Shitje/Blerjeje) dhe renditjen e tyre sipas prioritetit në Tregjet e Ankandeve të Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.

- Portofolat e Anëtarëve të Bursës që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi (PPT) Blerjeje, do të renditen në kurbën e grupuar të blerjeve sipas prioriteteve të mëposhtme:

1. Sasitë e energjisë elektrike të ofertuara nëpërmjet Portofolave si Urdhërporosi PPT bazuar në kontratat e brendshme afatgjata OTC midis blerësve dhe shitësve do të renditen në segmentin e parë të kurbës së grupuar të blerjeve. Këto kontrata do të tregtohen në ALPEX si kontrata tip financiare, të miratuara nga ERE, sipas parashikimeve në Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike. Këto kontrata duhet të deklarohen në ALPEX, nëpërmjet Mjetit Elektronik të Emëruar, jo më vonë se 5 (pesë) ditë para ditës së parë të livrimit, duke plotësuar formularin standard për këtë qëllim. Në rast se Mjeti Elektronik i Emëruar nuk është në funksion, atëherë procedura alternative e deklarimit në ALPEX të këtyre kontratave do të jetë dërgimi nëpërmjet postës elektronike, me adresë: trade@alpex.al dhe dot@alpex.al. Me dorëzimin e këtij formulari, ALPEX-i do të krijojë portofolat respektiv, ku pala blerëse do të ofertojë sasitë e energjisë elektrike të parashikuara në këtë kontratë. Pala blerëse njeh të drejtën e ALPEX-it për të aplikuar parashikimet e seksionit F.2.6, "E drejta për të refuzuar Urdhërporositë", të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme. ALPEX-i ka të drejtë të anulojë/fshijë Urdhërporositë në portofolin respektiv të blerësit si Urdhërporosi PPT, në rastin kur sasia e energjisë elektrike të ofertuar është më e vogël se sasia e vendosur në portofolin përkatës të shitësit si



Urdhërporosi PPT. Në rastin kur kjo sasi është më e madhe, në mënyrë që ALPEX-i mos të aplikojë të drejtën për të anuluar/fshirë urdhërporositë në portofolin respektiv të blerësit si Urdhërporosi PPT, duhet që pala shitëse të ketë ofertuar sasi në portofolat e tjerë, si Urdhërporosi të Thjeshta, të cilat së bashku me sasinë e ofertuar në portofolin përkatës të shitësit si Urdhërporosi PPT të jetë e barabartë ose më e madhe se sasia e energjisë elektrike e vendosur në portofolin PPT të blerësit. Në rast se shitësi do të ofertojë sasi të energjisë elektrike të kësaj kontrate vetëm nëpërmjet Portofolave me Urdhërporosi të Thjeshta, në mënyrë që ALPEX-i mos të aplikojë të drejtën për të anuluar/fshirë Urdhërporositë në Portofolin respektiv të blerësit si Urdhërporosi PPT duhet që pala shitëse të ketë ofertuar sasi jo më të vogël se sasia e energjisë elektrike të vendosur në portofolin PPT të blerësit.

2. Sasia e energjisë elektrike të ofertuar nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a., e vendosur si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Blerjeje për blerjen e humbjeve në treg të lirë do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të blerjeve.

3. Sasia e energjisë elektrike e ofertuar nga “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., e vendosur si Urdhërporosi Marrëse e me Përparësi Blerjeje për blerjen e humbjeve në treg të lirë, do të renditet e treta në kurbën e grupuar të blerjeve.

- Portofolat e Anëtarëve të Bursës, që duhet të vendosin Urdhërporosi Marrëse të Çmimit me Përparësi (PPT) Shitjeje, do të renditen në kurbën e grupuar të shitjeve sipas prioriteteve të mëposhtme:

1. Sasi të energjisë elektrike të ofertuara nëpërmjet Portofolave si Urdhërporosi PPT, bazuar në kontratat e brendshme afatgjata OTC midis blerësve dhe shitësve, do të renditen në segmentin e parë të kurbës së grupuar të shitjeve. Këto kontrata do të tregtohen në ALPEX si kontrata tip financiare, të miratuara nga ERE, sipas parashikimeve në Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike. Këto kontrata duhet të deklarohen në ALPEX nëpërmjet Mjetit Elektronik të Emëruar jo më vonë se 5 (pesë) ditë para ditës së parë të livrimit, duke plotësuar formularin standard për këtë qëllim. Në rast se Mjeti Elektronik i Emëruar nuk është në funksion, atëherë procedura alternative e deklarimit në ALPEX të këtyre kontratave do të jetë dërgimi nëpërmjet postës elektronike, me adresë: trade@alpex.al dhe

dot@alpex.al. Me dorëzimin e këtij formulari, ALPEX-i do të krijojë Portofolat respektiv ku pala blerëse do të ofertojë sasi të energjisë elektrike të parashikuara në këtë kontratë. Pala blerëse njeh të drejtën e ALPEX-it për të aplikuar parashikimet e seksionit F.2.6 F.2.6 “E drejta për të refuzuar Urdhërporositë”, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike - Kushtet e Përgjithshme. ALPEX-i ka të drejtë të anulojë/fshijë Urdhërporositë në portofolin respektiv të shitësit si Urdhërporosi PPT, në rastin kur sasia e energjisë elektrike e ofertuar është më e madhe se sasia e vendosur në portofolin përkatës të blerësit si Urdhërporosi PPT. Në rastin kur kjo sasi është më e vogël, në mënyrë që ALPEX-i mos të aplikojë të drejtën për të anuluar/fshirë urdhërporositë në portofolin respektiv të shitësit si Urdhërporosi PPT, duhet që pala shitëse të ketë ofertuar sasi në Portofolat me Urdhërporosi të Thjeshta, të cilat së bashku me sasinë e ofertuar në portofolin PPT përkatës të tij të jetë jo më e vogël se sasia e energjisë elektrike e vendosur në portofolin PPT të blerësit. Në rast se shitësi do të ofertojë sasi të energjisë elektrike të kësaj kontrate vetëm nëpërmjet Portofolave me Urdhërporosi të Thjeshta, në mënyrë që ALPEX-i mos të aplikojë të drejtën për të anuluar/fshirë Urdhërporositë në Portofolin respektiv të blerësit si Urdhërporosi PPT, duhet që pala shitëse të ketë ofertuar sasi jo më të vogël se sasia e energjisë elektrike të vendosur në portofolin PPT të blerësit. Shitësi mundet të vendosi se cila pjesë e sasisë ose e gjithë sasia e energjisë elektrike sipas kontratës së brendshme afatgjatë do të vendoset si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje nëpërmjet Portofolit PPT të krijuar për këtë qëllim. Nëse shitësi vendos që vetëm një pjesë e kësaj sasive do të vendoset si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje në Portofolin PPT përkatës, atëherë duhet që pjesën e mbetur e sasisë ta ofertojë nëpërmjet një portofoli tjetër (si një Urdhërporosi e Thjeshtë), ku sasia në një nga çiftet “Çmim–Sasi” të jetë minimalisht sasia e mbetur jashtë Portofolit PPT.

2. Sasia e energjisë elektrike të ofertuar nga entiteti që do të luajë rolin e Operatorit të Burimeve të Rinovueshme (REO) e vendosur si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje, do të renditet e dyta në kurbën e grupuar të shitjeve.

3. Sasia e energjisë elektrike e ofertuar nga KESH-i për energjinë elektrike, që do të prodhohet



në rastet e shkarkimit të detyruar të kaskadës dhe vendosur si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Shitjeje, do të renditet e treta në kurbën e grupuar të shitjeve.

- Sasitë e energjisë elektrike të ofertuara për këto kontrata të vendosura si Urdhërporosi Marrëse e Çmimit me Përparësi Blerje/Shitjeje apo Urdhërporosi e Thjeshtë nuk lejohen të ofertohen si Urdhërporosi në Bllok.”.

2. Aneksi nr. 3 i “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”, i miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 23.3.2023, shfuqizohet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1 korrik 2024.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

NJOFTIM

Nr. 10149, datë 3.7.2024

MBI HYRJEN NË FUQI TË MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për transportin ujor ndërkombëtar në liqenin e Ohrit, nënshkruar në Shkup, më 14.11.2022, ka hyrë në fuqi më 28 qershor 2024.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË

Nr. 310/10, datë 1.7.2024

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 428, datë 19.7.2023, Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit Rikonstruksion i rrugës ekzistues Vlorë–Orikum dhe dy *bypass*-eve në Radhimë, Vlorë”.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “arë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 36,881,231.58 (tridhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e dyqind e tridhjetë e një pikë pesëdhjetë e tetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Kastriot Gurra



LISTA EMËRORE, PARAPRAKE, E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME TË TË CILËVE PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 428, DATË 19.7.2023, ‘PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘RIKONSTRUKSION I RRUGËS EKZISTUES VLORË–ORIKUM DHE DY *BYPASS*-eve NË RADHIMË, VLORË’”

Nr. rendor	Zona	Pronari			Të dhënat kadastrale sipas kartelës së pasurisë				Të dhënat e shpronësimit			Vlera totale (lekë)	Adresa		Shënime (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
		Emër	Atësi	Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale	Zëri kadastral	Sipërfaqe shpronësimi (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		Bashkia	Fshati	
1	<i>By-Pass 2</i>	Alida	Alim	Dushku	3140	160/8/4	35,049	Arë	3,186	11,576.03	36,881,231.58	36,881,231.58	Vlorë	Radhimë	Konfirmuar nga ASHK Vlorë
Shuma totale paraprake												36,881,231.58			

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 176 lekë

